



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

RAPORT

PËR REZULTATET E KONSULTIMIT PUBLIK TË PROJEKTLIGJIN “PËR MASAT PËR ZVOGËLIMIN E KOSTOVE TË NDËRTIMIT TË RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE ME KAPACITETE SHUMË TË LARTA - AKTI I INFRASTRUKTURËS GIGABIT”

1. Titulli i projektit

Projektligji “Për masat për zvogëlimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta - Akti i Infrastrukturës Gigabit”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projektligji “Për masat për zvogëlimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta - Akti i Infrastrukturës Gigabit”, është propozim i Ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë, si ministër përgjegjës për telekomunikacionin, rrjetet e komunikimeve elektronike dhe ka për qëllim të lehtësojë e nxisë ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta (VHCN), përmes përdorimit të përbashkët të infrastrukturës fizike ekzistuese dhe një zhvillim më efikas të infrastrukturës fizike të re, nëpërmjet ndërtimit më shpejt dhe me kosto më të ulët të këtyre rrjeteve, si dhe të përcaktojë kërkesat minimale për arritjen e këtij qëllimi.

Përmes këtij projektligji synohet gjithashtu harmonizimi me ligjin e ri të komunikimeve elektronike nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” në veçanti lidhur me parashikimet për rrjetet e komunikimeve të kapaciteteve të larta VHCN.

Ky projektvendim është publikuar në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (në nivel ekspertit dhe qytetari) në datë 16 Prill 2026 deri në 14 Maj 2026, për një periudhë prej 20 ditë pune, në respektim të afatit ligjor të konsultimit.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për masat për zvogëlimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta - Akti i Infrastrukturës Gigabit”, ishin:

Projektvendimi “Për masat për zvogëlimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta - Akti i Infrastrukturës Gigabit”, ju nënshtrua konsultimit paraprak gjatë vitit 2025, përmes:

1. Desk Research;
2. Pyetësor dërguar bashkive;
3. Komunikime periodike me Agjencinë e Zhvillimit të Territorit;
4. Tryezë takimi e rumbullakët me grupe të interesit, operatorët, bashkitë, institucionet publike, 3 Nëntor 2025;

Gjatë vitit 2026, konsultimi u krye nëpërmjet metodave si më poshtë:

1. Nëpërmjet publikimit në Regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike nga data 16 Prill 2026 deri në 14 Maj 2026;
2. Nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në datë 16 Prill 2026 deri në 14 Maj 2026, të projektligjit dhe paketës shoqëruese;
3. Ndërmjet postës elektronike të koordinatorit për njoftim dhe konsultim publik: vilma.davidhi@infrastruktura.gov.al;
4. Tryezë takimi e rumbullakët me aktorë interesi, operatorë, bashkitë, institucione si (AKEP, ERE, ERU, OST, OSHEE, AZHT, AMVV, etj), shoqata e ndërtuesve, 6 Maj 2026;

5. Projektligji u prezantua në Këshillin Konsultativ të bashkëqeverisjes vendore me datë 14.5.2026 dhe është miratuar në parim, me vendimin nr. 7 të datës 26.5.2026 të Këshillit Konsultativ;
6. Në datë 25.5.2026, u organizua takim konsultues, në nivel teknik, për Projektligjin “Për masat për zvogëlimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta- Akti i Infrastrukturës Gigabit” me operatorët e rrjeteve të komunikimit elektronik, MIE, AKEP dhe perfaqesues te AZHT. Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi dhe trajtimi i komenteve dhe sugjerimeve të paraqitura në kuadër të procesit të konsultimit publik, të cilat u referohen dispozitave të projektligjit. Diskutimet teknike u adresuan nga pjesëmarrësit e institucioneve publike dhe palëve të interesuara në këtë proces.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Hartimi i projektligjit është bërë nga stafi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Në kuadër të hartimit të projekt ligjit janë zhvilluar takime me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Agjencinë e Zhvillimit të Territorit, për çështjet e lidhura me kuadrin ligjor për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën; Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato; Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Projektligji “Për masat për zvogëlimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta - Akti i Infrastrukturës Gigabit”, ka pasur 161 lexime nga qytetarët dhe 393 nga ekspertë, ndërsa janë administruar gjatë publikimit në regjistrin elektronik të njoftimit dhe konsultimit publik dhe ndërmjet postës elektronike, 4 (katër) komente, si më poshtë:

Nr	Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht /I refuzuar)	Justifikimi
1.	Komente rreth lejet/procedurat e ndërtimit të infrastrukturës që lidhen me Bashkin, AZHT si dhe gjobat.	Komente Albanian Satellite Communication -Neni 3 Përkufizime - Pika e aksesit në godinë ose pika fizike duhet të jetë në ambiente bashkëpronësie ose publike. Duhet të shtohet edhe Pjesë përbërëse e pikës së aksesit është edhe pika fizike pusetë e ndërtuar nga ndërtuesi I pallatit dhe tubacioni lidhës I pikës së aksesit me pikën fizike dhe me pusetën e rrjetit publik të bashkisë në trotuar apo rrugë. Pikë aksesi brenda godinës janë të paarrishme pasi të ketë përfunduar pallati dhe rikonstruksioni i trotuarit Neni 15	ALBANIAN SATELLITE COMMUNICATIONS (nepermjet RENJK dhe e-mail)	I pranuar pjesërisht	Për këtë qëllim më datë 25.5.2026, u organizua takim konsultues, në nivel teknik, për Projektligjin “Për masat për zvogëlimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta-Akti i Infrastrukturës Gigabit”. Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi dhe trajtimi i komenteve dhe sugjerimeve të paraqitura në kuadër të procesit të konsultimit publik, të cilat u referohen dispozitave të projektligjit.

		<p>Ndërtimi i infrastrukturës publike pika 5 - Në këtë paragraf përvec parashikimit duhet të shtohet edhe projektimi I saktë i tubacioneve dhe standartizimi i mënyrës së ndërtimit duke lidhur gjithë godinat në zonën e punimit Në mënyrë që të përfshihen lidhjet e infrastruktures së re me infrastrukturën ekzistuese publike për të siguruar vijueshmeri të rrjetit. Gjithashtu projekti duhet të përfshijë lidhjen e infrastruktures me çdo hyrje godine në atë zonë duke përfunduar në pikën fizike, në çdo kryqëzim duhet të bëhen traversime me tubacione e puseta si dhe të lidhen me infrastrukturen e rrugës që</p>		<p>Diskutimet teknike u adresuan nga pjesëmarrësit e institucioneve publike dhe palëve të interesuara në këtë proces. Lidhur me përkufizimet është marrë në konsideratë sugjerimi për ta referuar pikën e aksesit si pjesë të infrastrukturës së bashkëpronësi së. Po ashtu bere nje plotesim tek neni përkatës ku flitet për lidhjen e infrastrukturës /pikës së aksesit me rrjetin publik. Referuar komenteve për lehtësimin e procedurave të lejeve të ndërtimit është bërë plotësim në nenin 12 duke shtuar një pikë që parashikon nxjerrjen e një</p>
--	--	--	--	--

		<p>kryqëzon. Nëse tubacionet ekzistuese janë të pamjaftueshme duhet të parashikohet në projekt shtesa e tyre. Neni 17 Përjashtimi nga procedurat për leje ndërtimi pika 4 ose pike e re : - Duhet të parashikohet edhe një paragraf për punimet emergjente.</p> <p>Rasti I dëmtimeve nga palë të treta , ose dëmtime të qëllimshme . Njëlloj si në rastin e këputjeve të kablllove elektrike apo të tubave të ujit këputja e kablllove me kapacitet të lartë kërkon ndërhyrje të menjëhershme që mund të kërkojë punime te vogla civile por nuk mund të pritët për njoftime sic është parashikuar në këtë nen.. Neni 25 Miratimi i</p>			<p>akti nënligjor të vecante për lejet për rrjetet e komunikimeve elektronike VHCN pas konsultimit dhe me AZHT.</p>
--	--	--	--	--	---

	<p>heshtur i së drejtës së kalimit Miratimi I heshtur nuk jep të drejtën për të kaluar pasi organe kompetente për territorin apo inspektoriatë në rast të evidentimit në terren do të kërkojnë një leje që në këtë rast mungon dhe mund të penalizojë aplikuesin. Duhet të kushtëzohet me shprehje të miratimit. Neni 26 Lehtësimi I procedurave Propozojmë që të hiqet VNM gjë që do të shkurtonte kohën e marrjes së lejes me 2 muaj përveç kostove dhe afateve të vlefshmerisë për riaplikim. Neni 30 Infrastruktura e detyrueshme në ndërtimet e reja pika 1 Duhet të shtohet pjesa nga pika fizike publike deri në vendodhjen e</p>			
--	--	--	--	--

		<p>përdoruesit fundor. Për analogji lidhja e rrjetit elektrik apo ati të ujit bëhet nga pikat respektive të lidhjes deri tek pika e aksesit në godinë. Njelloj duhet të jetë edhe për infrastrukturen e rrjeteve VHCN Pika 4 Duhet të shtohet projektim I saktë I rrjetit fizik që të mundësojë vijueshmerine dhe lidhjen me infrastrukturën ekzistuese dhe zgjatimin deri tek hyrjet e godinave apo pikave të tyre të aksesit. Pa këto elemente rrjeti mund të bëhet I papërdorshëm pasi rruga apo trotuari të rikonstruktohet Neni 31 pika 7 Pika e aksesit për infrastrukturën VHCN në godinë Gjoha si akt administrativ do të jetë një vlerë që do ta mbledhe</p>			
--	--	---	--	--	--

		<p>autoriteti që do ta vendosë . Në këtë rast në këtë godinë rrjeti do të mungojë përsëri. Pra gjoba nuk e zgjidh çështjen. Duhet të shtohet edhe detyrimi që sipas një standarti të paraktuar apo me cmime reference të tregut AKEP apo autoriteti që certifikon godinën kontraktin një nga sipërmarësit e ndërtimit të rrjeteve që ta ndërtojë infrastrukturën e nevojshme dhe vlera ti faturohet ndërtuesit të godinës. Kjo do ta zgjidhte çështjen përfundimisht.</p> <p>Neni 39 gjobat pika C Gjoba është në akt administrativ por nuk zgjidh çështjen. Në rastet kur Sipërmaresit që marrin punë publike ndërtimore në</p>			
--	--	--	--	--	--

		<p>rrugë apo blloqe banimi etj për arësye të ndryshme mund të ndërtojnë vetëm një pjesë të rrjetit të tubacioneve të parashikuara ose lënë segmente të pa ndërtuata në mes të tij, kjo e bën të papërdorshëm rrjetin nëntokësor.</p> <p>Bashkitë apo autoriteti investitor duhet të jetë i detyruar që ta realizojë të gjithë infrastrukturen e tubacioneve ose të gjejë rrugë alternative për të siguruar vijueshmerine e rrjetit.</p>			
2.	Komente rreth perkufizimeve	<p>Komente mbi perkufizimet në nenin 3 si: operator rrjeti, facilitetet, facilitetet shoqeruese, ofrimi i nje rrejte te komunikimeve elektronike, ofruesi i sherbimeve te komunikeme</p>	Madcom (me e-mail)	Refuzuar	<p>Përkufizimet e projektligjit janë në përputhje me perkufizimet sipas Rregullores se BE 2024/1309/EU – Akti i Infrastrktores Gigabit, GIA.</p>

		publike, operator, rrjeti i komunikimeve elektronike, operator i infrastruktures			
3.	Komente rreth lejet/procedurat e ndertimit te infrastruktures qe lidhen me Bashkin, AZHT	Në vijim të konsultimit publik për projektligjin mbi masat për uljen e kostove të ndërtimit të rrjeteve VHCN, Vodafon e Albania ka përcjellë komentet dhe rekomandimet e saj me fokus në krijimin e një kuadri më efikas dhe praktik për zhvillimin e infrastrukturës digjitale në Shqipëri. Komentet tona adresojnë kryesisht nevojën për thjeshtimin e procedurave të lejeve, trajtimin proporcional të infrastrukturës mobile, integrimin e infrastrukturës së komunikimeve në zhvillimet e reja urbane, lehtësimin e	Vodafone Albania(me e-mail)	I pranuar pjesërisht	Për këtë qëllim me datë 25.05.2026, u organizua takim konsultues, në nivel teknik, për Projektligjin “Për masat për zvogëlimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta-Akti i Infrastrukturës Gigabit”. Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi dhe trajtimi i komenteve dhe sugjerimeve të paraqitura në kuadër të procesit të konsultimit publik, të cilat u referohen dispozitave të projektligjit. Diskutimet

		<p>aksesit në zona të mbrojtura dhe asete publike, si edhe nevojën për një kuadër më mbështetës për zhvillimin e rrjeteve 5G dhe përdorimin e lidhjeve microëave/E-band.</p> <p>Në tërësi, Vodafone vlerëson se projektligji përbën një hap pozitiv, por suksesi i tij do të varet nga adresimi i barrierave praktike që aktualisht ndikojnë në ritmin e investimeve dhe implementimin e rrjeteve me kapacitete shumë të larta.</p> <p>Komentet e detajuara gjenden në materialin bashkëlidhur.</p>			<p>teknike u adresuan nga pjesëmarrësit e institucioneve publike dhe palëve të interesuara në këtë proces.</p> <p>Referuar komenteve për lehtësimin e procedurave të lejeve të ndërtimit është bërë plotësim në nenin 12 duke shtuar një pikë që parashikon nxjerrjen e një akti nënligjor të vecante për lejet për rrjetet e komunikimeve elektronike VHCN pas konsultimit dhe me AZHT.</p>
--	--	---	--	--	--

4.	<p>Komente rreth lejet/procedurat e ndertimit te infrastruktu res qe lidhen me Bashkin, AZHT</p>	<p>Në kadër të këshillimit publik mbi projekt ligjin “Për masat për zvogëlimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta - Akti i Infrastrukturës Gigabit”, dhe në vijim të takimit të mbajtur nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ku u prezantuan dhe u trajtuan çështje shumë të rëndësishme të këtij projekt ligji duke i vënë edhe theksin përkatës, shoqëria ONE Albania gjen rastin të shprehë vlerësimin e saj mbi projekt ligjin e prezantuar, implementimi i të cilit mendojmë se do të adresojë zgjidhjen e çështjeve shumë të rëndësishme për tregun e</p>	<p>ONE Albania(me e-mail)</p>	<p>I pranuar pjesërisht</p>	<p>Për këtë qëllim me datë 25.5.2026, u organizua takim konsultues, në nivel teknik, për Projektligjin “Për masat për zvogëlimin e kostove të ndërtimit të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta- Akti i Infrastrukturës Gigabit”. Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi dhe trajtimi i komenteve dhe sugjerimeve të paraqitura në kuadër të procesit të konsultimit publik, të cilat u referohen dispozitave të projektligjit. Diskutimet teknike u adresuan nga pjesëmarrësit e institucioneve publike dhe</p>
----	--	---	-------------------------------	-----------------------------	---

		<p>komunikimeve elektronike.</p> <p>Ashtu sic u shprehëm edhe gjatë takimit të mbajtur, sugjerojmë që ne draft ligj të rishikohen disa parashikime me qëllim qartësimin e proceseve dhe shmangien e paqartësive dhe garantimin e zbatueshmërisë efektive të tyre.</p> <p>Sugjerimet tona i kemi paraqitur konkretisht dhe të detajuara edhe në draft ligjin bashkëngjitur.</p> <p>Ndërkohë më poshtë po paraqesim në formë të përmbledhur qëndrimin e shoqërisë ONE Albania lidhur me komentet e parashtruara në projek ligj:</p> <p>-Lidhur me aksesin në infrastrukturë fizike ;</p> <p>-Lidhur me koordinimin e punimeve civile ;</p>			<p>palëve të interesuara në këtë proces.</p> <p>Referuar komenteve për lehtësimin e procedurave të lejeve të ndërtimit është bërë plotësim në nenin 12 duke shtuar një pikë që parashikon nxjerrjen e një akti nënligjor të vecante për lejet për rrjetet e komunikimeve elektronike VHCN pas konsultimit dhe me AZHT.</p> <p>Gjithashtu janë reflektuar sugjerimet për rifomulim në nenin për koordinimin e punimeve civile si dhe është bërë plotësimi në nenin për infrastrukturën në godinë – lidhja me rrjetin publik.</p>
--	--	--	--	--	---

		-Lidhur me procedurën e dhënies së Lejeve; -Lidhur me përjashtimin nga procedurat për leje ndërtimi; -Lidhur me procedurat për të drejtën e kalimit; -Lidhur me aksesin në godina; -Lidhur me gjobat e aplikueshme;			
--	--	---	--	--	--